



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:018205  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05611953

KPPP.nr.1561/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbareme të kreditorit “STARSHPED” Sh.P.K., me NRB:810854283, me seli në Prizren, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina Rr.”Isa Boletini” nr.59, kundër debitorit Ministria e Mbrojtjes me seli në Prishtinë, Kazerma Adem Jashari, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.05/22 të datës 14.01.2022, të Përmbaremit Privat Ilir Z. Mulhaxha nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.05/22 i datës 14.01.2022, i lejuar nga Përmbaremi Privat Ilir Z. Mulhaxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.05/22 i datës 14.01.2022, i lejuar nga Përmbaremi Privat Ilir Z. Mulhaxha.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbareme për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 € (dy qind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “STARSHPED” Sh.P.K., me NRB:810854283, ka lëshuar urdhrin përmbareme P.nr.05/22 të datës 14.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbaremin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës me numër F-39261MI/2021 e datës 08.11.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit

në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur shumën prej 25,220.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 14.01.2022, deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet për përpilim të propozimit për përmbarrim në shumë prej 208.00 euro, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, ndër të tjerash ka theksuar se autoriteti kontraktues nuk e pranon një pagesë për shërbimet të cilat nuk janë kryer. Ka shtuar se menaxherët e kontratës asnjëherë nuk e kanë kontestuar mallin e dorëzuar për transport dhe pranimin e tij pas transportimit nga kreditori, mirëpo me qëllim i është shmangur përcaktimit sipas kushteve të kontratës duke e dyfishuar numrin e pozicioneve, nga dy pozicione në katër pozicione të njëjta, me qëllim të përfitimit të dyfishtë të vlerave financiare, duke ju shmangur kushteve të kontratës. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, dhe urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se me anë të prapësimin debitori konfirmon kryerjen e shërbimeve të transportit në përputhje me kontratën, pra kreditori ka dorëzuar mjetet që ka transportuar dhe të njëjtat janë pranuar pa vërejtje nga debitori. Ka shtuar se fatura i plotëson kriteret për tu cilësuar si dokument i besueshëm dhe se kemi të bëjmë me 4 njësi shërbimi vërtetohet më së miri nga dokumentet përmes të cilave është proceduar transporti i mjeteve të FSK-së, përkatësisht CMR-të në sasi prej 4 copë, ku në secilën është përshkruar mjeti që është dërguar për transport në rubrikën 6 të secilit prej tyre, pastaj në rubrikën 22 është nënshkruar nga dërguesi (debitori) dhe në rubrikën 24 nga pranuesi i automjeteve në Slloveni. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarrimor, dhe të obligohet debitori që të paguaj shpenzimet e procedurës në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 208.00 euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën me Numër F-39261MI/2021 e datës 08.11.2021, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht fatura e lartcekur i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se fatura është dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga nënshkrimi në fletë kthesën e postës e datës 13.12.2021, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar asnjëherë.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është

lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përbarimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se urdhri për përbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1561/22, datë 24.04.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.